



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

09 - 11 Prill 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL [®]
Agjenci e Lajmeve

Alarmante: Rreth 350 fëmijë me diabet!



Shkup, 9 prill - Rreth 350 fëmijë deri në moshën 15 vjecare shërohen nga diabeti në klinikën për diabet në Shkup. Madje është në rritje numri i të sëmurëve nga mosha 1 deri 4 vjecare, kështu bëjnë të ditur mjekët sipas të dhënave në sferën e shëndetësisë se si diabeti po 'gllabëron' fëmijët nëpër botë, njofton Zhurnal.

Ministri i shëndetësisë Todorov më 7 prill në ditën e shëndetësisë ka bërë të ditur se Maqedonia është në majat e listës në Europë me të sëmurë nga diabeti. Sipas të dhënave të fundit rreth 90 mijë qytetarë të

Maqedonisë jetojnë me diabet derisa 40 mijë prej tyre konsumojnë insulinë, transmeton Zhurnal.

Vdiq mjeku nga Gjevgjelia, i dyshuar për vdekjen e një gruaje dhe foshnjës së saj

Gjevgjeli, 9 prill - Ka vdekur njëri nga dy anesteziologët të cilët janë të dyshuar për vdekjen e një gruaje së bashku me fëmijën e saj të palindur nga Gjevgjelia.

Nëna e re dhe foshnja vdiqën gjatë lindjes në spitalin e Gjevgjelisë.

Policia konfirmoi ngjarjen e vdekjes anesteziologut , por thanë se nuk kanë më shumë informacion nëse vdekja ishte e dhunshme, transmeton TetovaSot.

Sot është kryer edhe varrosja e mjekut.

Pas incidentit dy anesteziologët i humbën licencat e tyre, si dhe u pushuan nga puna.

Analiza e gjakut tregoi se kur ata i bën prerje cezariane nëna ishin në gjendje të dehur.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



TETOVA

shpejt dhe ndryshe

Rreth 700 mjekë kanë ikur nga Maqedonia



Të pakënaqur me pagën që marrin dhe kushtet që ua ofron vendi i tyre, rreth 700 mjekë të rinj kanë braktisur profesionin e tyre në Maqedoni dhe ia kanë mësy Evropës për një jetë dhe standard më të mirë. Kështu deklaroi Simon Siljanovski, kryetar nderi i Sindikatës së Shëndetësisë në Maqedoni, i cili sheh rrezik se ky trend i ikjes do të vazhdojë edhe në të ardhmen

“Sigurisht tërhiqen nga kushtet e punës që gjithsesi janë më të mira atje. Kanë kushte të mrekullueshme që i ka krijuar shteti dhe atë që ua ofrojnë si të ardhura personale. Dallimi në rroga, për shembull në

Kuvajtin evropian, pra në Norvegji dhe Maqedoni është qesharake. Rroga jonë mujore është sa ajo e tyre ditore”, deklaroi Siljanovski.

Largimi i mjekëve është vërejtur gati nëpër të gjitha qendrat e këtij shteti, përfshirë edhe lokalitetet shqiptare. Asim Musa, drejtor i spitalit për dializë në Strugë, shkakun për ikjen e mjekëve e sheh në pagat e ulëta, citon AlsatM.

Ndërkohë kryetari i nderit i Sindikatës së Shëndetësisë Simon Siljanovski alarmon edhe për një rrezik tjetër në fushën e shëndetësisë. Sipas tij largimi i mjekëve të rinj do të pamundësojë zëvendësimin specialistëve të cilët janë para pensionit. Prandaj ai kërkon që institucionalisht të bëhet diçka në këtë drejtim.

“Drama që pritet është se në rreth 2 mijë specialistë, diku rreth 70 për qind jemi para pensionimit. Kjo është alarmuese dhe nuk e di çfarë do të bëhet më pas”, tha sindikalisti Siljanovski.

Edhe Musa thotë se në spitalin e tyre në Strugë tashmë ka mungesë të mjekëve në reparte të ndryshme. Gjendja e njëjtë është edhe në spitalin e Ohrit ku ndjehet mungesa e mjekëve në disa reparte.

PORTAL INFORMATIV
Tetova1

Rreth 700 mjekë të rinj kanë braktisur Maqedoninë



Rreth 700 mjekë të rinj të pakënaqur nga paga kanë braktisur Maqedoninë dhe i'a kanë shkuar në Evropë, njofton për Alsat M Simon Siljanovski, kryetar nderi i Sindikatës së shëndetësisë për Maqedoni.

Ai pret që numri i atyre mjekëve që shkojnë jashtë shtetit, do të rritet



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



edhe më tej, nëse në shtetet evropiane vazhdojnë tu ofrohen kushte për punë si mjek.

“Sigurisht tërhiqen nga kushtet e punës që gjithsesi janë më të mira atje, sepse kanë kushte të jashtëzakonshme që i ka krijuar shteti dhe atë që ua ofrojnë si të ardhura personale. Dallimi në rroga, për shembull në Kuvajtin evropian, pra në Norvegji dhe Maqedoni është qesharake. Rroga jonë mujore është sa ajo e tyre ditore”. Mendoj se, ashtu siç kam dëgjuar, përmes odave të shëndetësisë, rreth 700 mjek të rinj për dy vjet e kanë braktisur vendin“, tha Siljanoski.



Fushata të reja për siguri në komunikacion



Këshilli republikan për siguri në komunikacionin rrugorë filloi sot dy fushata të reja me moton...

Këshilli republikan për siguri në komunikacionin rrugorë filloi sot dy fushata të reja me moton "Rugëve u nevojiten shoferë përgjegjës" dhe "Jeta nuk jep mundësi të dytë, vozit me përgjegjësi". Fushatat do të realizohen në gjashtë muajt e ardhshëm përmes bilbordeve, reklamave në rrjetet sociale Facebook dhe Twitter dhe nëpërmjet afisheve.

Paralelisht me fushatat do të realizohen ngjarje edukative, ligjërata, aksione parandaluese dhe në terren të cilat duhet ta afrojnë temën deri te të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.

Këtë në konferencën e sotme për shtyp e kumtoi kryetari i Këshillit republikan për siguri në komunikacionin rrugorë Stojçe Stamenkovski.

Në dy vitet e fundit në Maqedoni kanë ndodhur 7.500 aksidente me persona të lënduar apo viktime.

Vetëm në vitin 2014 ka pasur 115 aksidente me viktime, ndërsa në vitin 2015 ka pasur 135 aksidente me viktime.

Sipas statistikave, këmbësorët janë kategoria më e prekur e pjesëmarrësve në komunikacion.